



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 109, Datë 10.06.2024

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ 2024 PËR KLIENTËT E
LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1477/1 prot., datë 07.06.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Maj 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatohet se:

- Shoqëria FSHU sh.a ka përcjellë në ERE shkresën nr. 3874 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1477 prot., datë 05.06.2024, me lëndë “Kërkesë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët 35 kV për muajin Maj 2024”. Referuar kërkesës së depozituar, shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh për muajin Maj 2024 nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).
- Mbështetur në nenin 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Maj 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, i përlogaritur dhe propozuar nga shoqëria për muajin Maj 2024 rezulton në vlerën 10.73 lekë/kWh. FSHU sh.a. bën me dije gjithashtu se:
“Duke qenë se sipas nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga Furnizuesit i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin nr.201 datë 04.12.2017 të Bordit të ERE-s i ndryshuar, në çmimin e përlllogaritur nuk parashikohen kostot e disbalancave këtij çmimi në faturën e energjisë elektrike FSHU sh.a i shton edhe kostot e disbalancave të përlllogaritura për muajin Shkurt 2024".

- Bazuar në nenin 8, të metodologjisë së sipërcituar , të miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët e marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë si në vijim:
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
 - **Kostot administrative**, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, vijojnë të jenë 1.06 lekë/kWh.
 - **Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë Lekë/Euro**, për çdo datë respektive të harkut kohor 30.04.2024 – 30.05.2024.
- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Maj 2024, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Maj 2024</i>			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	7.06
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.21
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CALeke/kWh			10.73

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 10.73 Lekë/kWh për muajin Maj 2024.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin muajin **Maj 2024 prej 10.73 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.**
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI